


Bibël për fëmijët
paraqet

Një Kohë e
Tmerrshme
për Jezusin



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus

Adaptuar nga: M. Maillot; Sarah S.

Alastair Paterson

Përkthyer nga: Arianit Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children

www.M1914.org

©2020 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Kur Jezusi
u pagëzua,
Perëndia foli.
Ai tha, "Ky është
Biri Im i dashur.
Në Të, Unë jam
kënaqur". Fryma
e Shenjtë e
Perëndisë
zbriti mbi
Jezusin si
një pëllumb.



Shpejt pas kësaj,
Fryma e Shenjtë e
Perëndisë e drejtoi
Jezusin në një vend
të shkretë. Jezusi
ishte vetëm.



Jezusi agjëroi për dyzet ditë. Kjo do të thotë që Ai nuk hëngri asnjë ushqim. Atë e mori shumë uria.



Bibla thotë se kafshët e egra ishin gjithashtu atje.



Satani erdhi të tundojë Jezusin.
Kohë më parë ai kishte tunduar
Adamin dhe Evën për të mos iu
bindur Perëndisë në Kopshtin e
Edenit. Tani, Jezusi do
të provohej.



Satani mund të
provonte të tundonte
madje edhe Birin e
Perëndisë, Jezusin.



"Nëse Ti je Biri i Perëndisë", tha djalli, "Ktheji këta gurë në bukë".
Ai e dinte që Jezusi ishte i uritur.
Ai e dinte se Biri i Perëndisë mund ti kthente gurët në bukë.
A do ti bindej Jezusi djallit?



Jo! Jezusi nuk iu bind djallit. Përkundrazi, Ai iu përgjigj nga Fjala e Perëndisë. "Njeriu nuk do të jetojë vetëm me bukë, por nga çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë".



Pastaj Satani e çoi Jezusin në qytetin e madh të Jerusalemit, në tempullin e shenjtë ku njerëzit adhuronin Perëndinë. Çfarë do të bënte djalli më pas.



"Nëse Ti je Biri i
Perëndisë, hidhu poshtë",
tha djalli. "Fjala e Tij
thotë se engjëjt e Tij
do të të shpëtojnë".



"Jo"! U përgjigj Jezusi. "Është shkruar gjithashtu... 'Nuk do ta tundosh ZOTIN, Perëndinë tënd'".






Djalli e provoi sërisht. Ai e nxorri Jezusin jashtë qytetit në një majë shumë të lartë mali.



Duke i treguar Jezusit të gjithë lavdinë e çdo mbretërie tokësore, djalli tha, "Unë do ta jap të gjithën ty, nëse bie përmbys dhe më adhuron".



"Largohu prej meje, Satan", Urdhëroi Jezusi.
"Eshtë shkruar... 'Ti do të adhurosh ZOTIN,
Perëndinë tënd dhe vetëm Atij
do ti shërbesh".



Djalli e la Jezusin për pak. Atëherë diçka e mrekullueshme ndodhi. Perëndia dërgoi engjëjt ta ngushëllonin dhe të kujdeseshin për Jezusin, Birin e Tij - i Cili nuk iu bind djallit.



Një Kohë e Tmerrshme për Jezusin

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Mateut 4, Llukës 4

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

